



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	27.08.2024
REFERENC-Ë:	24/2145/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"Euro Via" Sh.p.k - Zahaq, Pejë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, e ka shqyrtuar kërkesën për Pëlqim Mjedisor të dërguar nga kompania e Juaj me nr.prot.: 24/2145/197/DMMU, dhe pas shqyrtimit të bërë ka vendosur si në vendimin e bashkangjitur të kësaj letërpërcjellëse.

Vendimi për Refuzimin e kërkesës së Kompanisë "Euro Via" Sh.p.k - Zahaq, Pejë për përdorimin e Argjilës në ZK Serbicë e Poshtme, Prizren.

Me respekt,

Faqe 1 nga 3

Adresa: Objekti i Ri Qeveritar, ish Pallati i Mediave "Rilindja" kati 17, nr: 1713 - 10 000 Prishtinë - Kosovë

Telefon: + 381 38-200-32-307

<http://www.ks-gov.net/mmphi>, E-mail: [zsp.mmphi@ks-gov.net](mailto:zsp.mmphi@ks-gov.net)



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
Ministarstvo Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture  
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*

*Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary*

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 29, të Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025 si dhe dispozitave ligjore të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 08/L-181, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Refuzimin** e kërkesës së kompanisë "Euro Via" Sh.p.k - Zahaq, Pejë - për Shfrytëzimin e Argjilës në ZK Serbicë e Poshtme, Prizren.

**A r s y e t i m**

Gjatë shqyrtimit të Kërkesës nga ana e Komisionit për raportin e VNM-së si dhe dokumenteve përcjellëse të Kompanisë "Euro Via" Sh.p.k - Zahaq, Pejë, me datën 29.04.2024, është kërkuar nga Kompania që të sjellë informatën nga Komuna ku specifikohet se a lejohet shfrytëzimi i argjilës në ngastrat kadastrale të lartëcekura.

Kompania në fjalë me datën 28.05.2024 ka sjellë informatat shtesë - njoftimin nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor të Komunës së Prizrenit.

Faqe 2 nga 3



Komisioni në takimin e rradhës, me 27.08.2024 ka shqyrtuar njoftimin e pranuar nga Drejtoria e Urbanizimit dhe Planifikimit Hapësinor të Komunës së Prizrenit dhe ka knstatuar se ngastrat kadastrale P-71813020-00644-1 dhe P-71813020-00644-4 në ZK Serbicë e Poshtme, Prizren sipas HZK gjenden në Zonën Bujqësore - ZB dhe në bazë të pjesës tekstuale të bashkangjitur këtij njoftimi në Zonën Bujqësore ndalohet zhvillimi i aktivitetit të tillë.

Bazuar në të lartcekuat, MMPHI merr **Vendim për Reuzimin** e kërkesës për paisje me Pëlqim Mjedisor për Kompaninë "Euro Via" Sh.p.k - Zahaq, Komuna Pejë për Shfrytëzimin e Argjilës në ZK Serbicë e Poshtme, Prizren.

**Shpjegim për palën:** Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për riaplikim sipas procedurës së rregullt.

**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicoj konflikt administrativ me padi në Gjykatën Themelore në afat 30 ditësh nga dita e pranimit e të njëjtit.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 24/2145/1- ZSP/ /24 datë: 27.08.2024

Prishtinë

T'i dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës
2. Komisionit për VNM
3. Inspektoratit
4. Komunes se Prizrenit
5. Kabinetit të Ministrit
6. Divizioni për komunikim me publikun
7. Arkivit të MMPHI



Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm  
të MMPHI